



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETETERORE PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE			
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT, KANCELARIAJA ARKIVA - ARCHIVE OFFICE			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Hr. Prot. Prot. No:	146
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	02	Data Datum Date:	21, 08, 2013
PRISHTINËJA			

Nr. prot. 31/2013
Datë: 20.08.2013

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. Këshillohet "Viva Fresh Store" Veternik, të nxjerr vendim dhe të vendos njoftimin për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Ndalohet përpunimi i karakteristikave biometrike (gjurmët e gishtërinjve) për të të punësuarit në "Viva Fresh Store" Veternik.
3. "Viva Fresh Store" Veternik, në afat prej 15 ditësh ta njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 22.07.2013, Agjencia ka zhvilluar një takim pune me c' rast ka realizuar një inspektim sipas detyrës zyrtare në "Viva Fresh Store" Veternik.

Pas inspektimit është përpiluar procesverbali me nr.14/2013, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të inspektimit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Në hyrje të objektit "Viva Fresh Store" Veternik, nuk ka shenja paralajmruese se objekti është në vëzhgim të kamerave. Në objekt janë të instaluar disa kamera të vëzhgimit që mbikqyren nga një qendër monitoruese. Nuk ka vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Në "Viva Fresh Store" Veternik, bëhet marrja e karakteristikave biometrike për të të gjithë të punësuarit (afër 200 të punësuar), e që sipas zyrtarëve bëhet për mbarëvajtjen e ardhjes dhe daljes në punë.

“Viva Fresh Store” Veternik, nuk i ka bërë kërkesë Agjencisë për marrjen e autorizimit për përpunimin e karakteristikave biometrike.

Në nenin 61 (paragrafi 2) të LMDHP parashihet se personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t’i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur vëzhgimi me kamerë fillon.

Në nenin 64 (paragrafi 4) të LMDHP parashihet që para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë punëdhënësi duhet t’i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshatshme.

Në nenin 68 (paragrafi 1) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që sektori privat mund të përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve, për sigurimin e pronës ose për mbrojtje të të dhënave konfidenciale ose sekreteve të biznesit. Të punësuarit duhet të informohen paraprakisht në formë të shkruar për përdorimin e karakteristikave të tyre biometrike, rreth masave që do të merren dhe të drejtat e tyre.

Në nenin 68 (paragrafi 2) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj përkatës, kontrolluesi i të dhënave duhet që para marrjes së masave për përdorimin e karakteristikave biometrike t’i ofrojë Agjencisë përshkrimin e detajuar për masat që do të merren duke përfshirë informacionet që do t’i jepen subjektit të të dhënave, arsyet për marrjen e masave dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në nenin 68 (paragrafi 3) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që pas marrjes së informacionit nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të vendosë nëse informacioni i marrë lidhur me masat është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Në nenin 68 (paragrafi 4) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që kontrolluesit e të dhënave mund të zbatojnë masat për përdorimin e karakteristikave biometrike, pas marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- “Viva Fresh Store” Veternik
- Arkivit të Agjencisë

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë 2

